

FIP
FEDERATA NDËRKOMBËTARE E FILATELISË
THEMELUAR MË 1926

RREGULLA TË VEÇANTA PËR VLERËSIMIN E EKSPONATEVE TË MAKSIMAFILISË NË EKSPOZITAT E FIP-it (SREV)

Neni 1:Ekspozita konkurruese

Këto rregulla të veçanta janë hartuar në përputhje me nenin 1.5 të “Rregullave të përgjithshme të FIP-it për vlerësimin e ekspozitave konkurruese në ekspozitat e FIP-it(GREV)” për të përplotësuar parimet në lidhje me Maksimafilinë. Referoju gjithashtu “Udhëzimeve për gjykimin e ekspozitave të Maksimafilisë”.

Neni 2:Ekspozitat konkurruese

Kartat maksimum duhet të jenë konform parimeve të përputhjes maksimale të mundshme ndërmjet:

- a) Pullës postare
- b) Pamjes së kartolinës
- c) Vulosjes

Neni 3:Parimet e ndërtimit të ekspozitave.

Elementët përbërës të kartave maksimum duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

3.1. Pulla postare

Dizenjimi i “Pullës postare” i takon operatorit postar që është caktuar të garantojë shërbimin universal në një vend anëtar të UPU-së(Bashkimi postar botëror) ose në një territor brenda një vendi. Pulla postare mund të jetë e personalizuar sipas kërkesës së klientit(individ,shoqatë,kompani,...) me kusht që të jetë në dispozicion të publikut të gjërë. Ajo duhet të jetë e vlefshme për postim e ngjitur vetëm mbi pamjen e kartolinës. Pullat taksë, të vulosura më parë, pullat fiskale, pullat që janë në kundërshtim me” kodin e etikës të filatelisë të UPU(Bashkimit Ndërkombëtar Postar)” nuk lejohen; nuk lejohen gjithashtu pullat zyrtare përveç atyre që janë në dispozicion të publikut(Kombeve të Bashkuara,UNESCO-s,Këshillit të Europës,...).Pullat postare që janë prerë nga kartat postare lejohen vetëm në qoftë se shërbimi postar emetues e lejon përdorimin e tyre. Nuk lejohen pullat postare të printuara online. Pullat e emetuara nga operatorët postarë të autorizuar nga qeveria përkatëse lejohen në të njëjtat kondita si dhe pullat postare.

3.2. Kartolina

Madhësia e saj duhet të jetë në përputhje me dimensionet e pranuar nga “Konventa Postare Botërore”. Megjithatë pranohen edhe kartat katrore apo drejtëkëndëshe që janë në treg me kusht që ato të mund të vendosen në formatin A4(210x297 mm²), 2 copë për fletë. Në respekt të dizenjatorit është krejtësisht e ndaluar të reduktosh madhësinë e kartolinës duke e prerë atë.

Pamja duhet të pasqyrojë përputhjen me të mirë të mundshme me temën e pullës postare, ose me njërin prej tyre nëse ka disa. Nuk lejohen të gjitha kartolinat, që riprodhojnë plotësisht pullën postare, domethënë birimin, vlerën dhe emrin e vëndit.

Pamja duhet të tërheqë vëmendjen për temën e pullës postare. Kartolinat në treg pranohen siç janë.Ato mund të kenë anë të bardha si dhe tekst që ka lidhje direkt me temën e pullës. Kartolinat e vjetra mund të kenë në anën ballore një zonë për korrespondencën. Me përjashtim të këtyre kartolinave të vjetra, sa më e madhe të jetë pamja aq më i mirë do të jetë vlerësimi për kartën maksimum.Kartolinat me shumë pamje dhe ato me holograma nuk lejohen.

3.3 Vulosja

Vulosja duhet të realizohet vetëm nga shërbimi postar i autorizuar. Dizenjo e vulës dhe/ose teksti si dhe vëndi i vulosjes(emri i Zyrës Postare) duhet të kenë lidhje me subjektin e pullës dhe kartolinën ose me qëllimin e emetimit (ngjarje, aktivitet bamirës, temën e serisë).Megjithatë vulosjet e realizuara nga shërbimet filatelike, pranohen me kusht që përputhja me vëndin është respektuar. Lejohen vulosjet e bëra nga shërbimi filatelik i vendeve të vogla vetëm me emrin e vëndit(shtetit).

Sa më e ngushtë është lidhja ndërmjet temës dhe pamjes dhe/ose tekstit të një vule të dizenuar aq më e mire konsiderohet përputhja.

Vulosjet e zakonshme pa ilustrim vlejné me kusht që të respektohet përputhja me vendin.

Vulosja duhet të realizohet brënda periudhës së vlefshmërisë së pullës postare dhe sa të jetë e mundur më afër datës së emetimit.

3.4 Klasifikimi i eksponateve.

Eksponatet e maksimafilisë mund të klasifikohen nga:

- a) Vëndi ose një grup vëndesh.
- b) fusha ose studim e/i specializuar.
- c) Tema

3.5 Plani

Në fletën e pare, titulli dhe plani formojné një të tërë në përputhje të plotë me materialin e ekspozuar. (Referoju GREV, neni 3.3). Koncepti, struktura dhe trajtimi i eksponatit duhet të jenë përcaktuar qartë.

Neni 4: Kriteret për vlerësimin e eksponateve

Vlerësimi i eksponateve në ekspozitat e FIP-it bëhet sipas kriterëve të përgjithshme të përcaktuara qartë (referoju GREV neni 4).

Për eksponatet e maksimafilisë i jepet rëndësi e veçantë njohurive dhe përputhjes maksimale të mundshme që ke parashtruar (referoju udhëzimeve).

Neni 5: Gjykimi i eksponateve

5.1. Eksponatet e maksimafilisë gjykohen nga specialistë të aprovuar në klasën e maksimafilisë dhe në përputhje me kapitullin V, nenet 31 deri 46 të GREX (referoju GREV, neni 5.1)

5.2. Për eksponatet e maksimafilisë po paraqesim më poshtë kushtet përkatëse që e çojnë jurinë në një vlerësim të ekuilibruar (referoju GREV, neni 5.2).

▶ Trajtimi dhe shtrirja e eksponatit	30
▶ Njohuria dhe kërkimi	35
▶ Gjëndja dhe rrallësia	30
▶ Paraqitja	5

	100

Neni 6 Klauzola përmbyllëse

6.1. Në rast të ndonjë paqartësie në tekst që rrjedh nga përkthimi, përparësi do të ketë teksti në anglisht.

6.2. Këto “Rregulla të veçanta për vlerësimin e eksponateve të Maksimafilisë në ekspozitat e FIP-it” u pranuan unanimitet nga Komisioni i Maksimafilisë i FIP-it në Konferencën e mbajtur në Xhakarta më 22 qershor 2012 pasuar me qartësimin e paragrafit 3.1 me terminologji të thjeshtë dhe të qartë, të pranuar nga anëtarët e Byrosë së komisionit të maksimafilisë së FIP-it më 9 nëntor 2013 dhe aprovuar nga Bordi i FIP-it në Rio De Zhanero më 23 nëntor 2013.

Përkthyer nga Edmond Budo
25.07.2015